

**THIRRJE PËR TË RINJ 16 – 25 VJEÇARË**  
**Ta ndërtojmë bashkërisht të ardhmen e qëndrueshme të Kosovës!**

**Projekti ToKeQark SB NI KOS 09/2023**

Jeni një person i ri (16-25), gati për të kontribuar për një të ardhme më të qëndrueshme për Kosovën? Nëse po, ju ftojmë të bëheni pjesë e projektit "ToKeQark"!

"ToKeQark" është një nismë inovative për të adresuar sfidat mjedisore dhe tranzicionin në ekonominë qarkore në Kosovë. Projekti ka si qëllim kryesor të angazhojë dhe të fuqizojë grupe të ndryshme të shoqërisë, me thekst të posaçëm tek të rinjtë si ju, për të gjetur zgjidhje inovative të përshtatshme për sfidat e ndryshimeve klimatike dhe për të promovuar konceptin e ekonomisë qarkore.

Ne do të krijojmë një rrjet të fuqishëm me 60 të rinj dinamikë dhe të motivuar për të sjellë ndryshime të dukshme dhe pozitive në jetët e qytetarëve në katër komuna të Kosovës: Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë dhe Mitrovicë dhe ta zgjerojnë ndikimin edhe më tej.

Si pjesëmarrës i "ToKeQark" ju keni rol kyç për t'i kontribuar të ardhmes më të qëndrueshme. Përvoja juaj është shumë e rëndësishme në krijimin dhe zbatimin e zgjidhjeve inovative që adresojnë sfidat mjedisore dhe për të promovuar parimet e ekonomisë qarkore. Të gjithë të rinjtë 16-25 vjeç nga komunat Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë dhe Mitrovicë janë të mirëseardhur të aplikojnë!

Aplikoni duke plotësuar këtë [formular](#), duke u siguruar se i jepni të gjitha informacionet e nevojshme dhe motivimin që të bëheni pjesë e këtij projekti. Aplikantët e suksesshëm do të njoftohen edhe për përfitimet nga pjesëmarrja në aktivitete.

Afati i aplikimit: 5 gusht 2023

Bëhu pjesë e rrjetit "ToKeQark"!

Projekti financohet nga SMART BALKANS, i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA) dhe zbatohet nga The Balkan Forum.